



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VEDNIM

Veprimi sipas lëndës me numër 12-9294/1 të datës 17.11.2022, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja vërtetoi se sipas lëndës nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm kompetent.

Lënda me numër 12-9294 të datës 2022 të mbyllet dhe të arkivohet

Ky vendim në formë të depersonalizuar të publikohet në ueb faqen e KSHPK-së në afat prej 5(pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-9294/1 datë 17.11.2022 është formuar me vetiniciativë të KSHPK-së dhe në lidhje me informacionin e publikuar publikisht me pretendimet se udhëheqësia e /// konteston përzgjedhjen e tetë kandidatëve për kontrollorë të trafikut ajror, gjoja me qëllim nepotizmi dhe ndikimesh politike për të zgjedhur kandidatë të tjerë.

Në lidhje me këtë çështje, KSHPK-ja ka kërkuar të dhëna, informacione dhe dokumentacion nga subjekti i lartpërmendur. Nga përgjigja e dorëzuar dhe bashkëngjitjet, mund të konstatohet se në rastin konkret, përzgjedhja e kandidatëve për kontrollorë të trafikut ajror është bërë përmes prokurimit publik të shërbimeve të trajnimit, sipas kritereve të përcaktuara rreptësisht nga trajneri i kandidatit dhe në përputhje me profesionalizmin e standardeve për kontrollorët e trafikut ajror. Para së gjithash, u konstatua nevoja për rekrutim dhe përzgjedhje të kandidatëve për kontrollorë të trafikut ajror - nevoja për 8 persona, më pas u krye prokurimi publik për zgjedhjen e një trajneri dhe më pas u miratua një plan veprimi për rekrutimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për kontrollorë të trafikut ajror. Më pas është shpallur njoftimi publik për përzgjedhjen e kandidatëve, në të cilin kandidatët kanë dorëzuar aplikacionet, pas së cilës ka pasur një fazë të shqyrtimit të aplikacioneve të dorëzuara pas njoftimit publik. E gjithë kjo ishte gjatë vitit///. Më në fund u afrua përzgjedhja e kandidatëve për kontrollorë të trafikut ajror, proces i cili përfshinte para përzgjedhjen, procesin e testimit të kandidatëve me testin /// (në /// pjesë), kryerjen e një interviste me kandidatët që kaluan të tria pjesët e testit të përmendur më parë me trajnerin, pastaj ekzaminimet mjekësore me kandidatët e përzgjedhur, pas së cilës u

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Адреса: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

përpilua lista e propozuar me 8 kandidatët e renditur më mirë. Me këta kandidatë është zhvilluar edhe një intervistë, pas së cilës Bordi Drejtues i /// me Vendimin nr. ///, konfirmoi listën e propozuar të kandidatëve të renditur më mirë.



Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Dorëzuar:
- Arkivi i KSHPK-së

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: Mr. V.G

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetare,
Katica Nikolovska**

